

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH. A.

**APLIKIM TARIFOR
PËR VITIN 2009**

**DREJTUAR
ZYRËS TË RREGULLATORIT TË ENERGISË TË KOSOVËS**

Shkurt 2009

Përmbajtja:

1	Hyrje	3
2	Strategjia Tarifore	5
2.1	Tarifat e Furnizimit me Pakicë	5
2.2	Tarifa e Shitjeve me Pakicë	6
3	Të Ardhurat e Lejuara	8
3.1	Të Ardhurat e Lejuara për Furnizim me Pakicë.....	9
4	Freskimi i tarifave ekzistuese.....	11
4.1	Studimi i Alokimit të Kostos (të Shërbimit).....	11
4.2	Procesi Tarifor	13
4.3	Përcaktuesit e Faturimit	15
4.4	Tarifat e Propozuara.....	17
4.5	Të Ndryshme.....	18
5	Ndryshimet e propozuara.....	19
5.1	Përshkrimi i Modifikimit të Grupeve Tarifore.....	19
6	Këshillimet.....	20
7	Tabela nr. 1, Tarifat ekzistuese	21
8	Tabela nr. 2, Tarifat e Propozuara krahasuar me tarifat ekzistuese	22

1 Hyrje

Bazuar në Udhëzimet për Aplikimin Tarifor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Republikën e Kosovës të aprovuar më datën: 27 Prill 2006, në përputhje me formën që e përmban Apendiksi A. 1, KEK Sh. A. i drejtohet ZRrE-së me këtë Aplikacion për aprovimin e çmimeve të rishikuara për tarifa të rregulluara të energjisë elektrike për vitin 2009.

Ky Aplikim Tarifor është përgatitur në formë elektronike dhe në letër në pajtim me orarin e përmbajtur në Rregullën mbi Çmimet në mënyrën më të kuptueshme duke lënë vend për informata shtesë nga ana e ZRrE-së deri sa të arrihet forma e plotë e aplikimit për tarifa të rregulluara.

Aplikimi është përgatitur për:

Ngarkesat për Energjinë Elektrike të prodhuar dhe të importuar,

Ngarkesat për Shfrytëzimin e Rrjetit Shpërndarës dhe

Ngarkesat e Furnizimit dhe

Shitjet me Pakicë për Konsumatorët e rregulluar të kyçur në nivele të ndryshme të tensionit.

Duke ju nënshtuar udhëzimeve të ZRrE-së për Aplikim Tarifor, Aplikacioni përmban pesë seksione të shoqëruara me dy tabela raportuese si faqe Excel MS.

Seksionet:

1. Strategjia tarifore,
2. Të ardhurat e lejuara,
3. Freskimi i tarifave ekzistuese,
4. Ndryshimet e propozuara dhe
5. Këshillimet

Tabelat raportuese:

1. Tabela Raportuese 1: Tarifat Ekzistuese,
2. Tabela Raportuese 2: Tarifat e Ndryshuara

Në shtojcë të Aplikacionit KEK-u dorëzon llogaritjen e të hyrave të lejuara sipas Modelit Tarifor të KEK-ut ku përfshihen:

- Bilanci Energjetik,
- Kostot e blerjes së Energjisë Elektrike,
- Kostot e mihjeve,
- Kostot e gjenerimit,
- Kostot e shpërndarjes,
- Kostot e furnizimit dhe
- Kostot e drejtorisë.

Ne po ashtu dorëzojmë të dhënat e kërkuara nga ZRrE-ja për modelin e tyre tarifor.

Pikat kryesore të këtij aplikimi përfshijnë:

- Kërkesat e KEK-ut për të Hyrat e Lejuara në vlerë prej 163,015,582 Euro. Pjesa më e madhe e tyre është e lidhur me veprimtarin, mirëmbajtjen, dhe shpenzimet kapitale në miniera për të siguruar furnizimin të nevojshëm me thëngjill.
- Energjia Elektrike e importuar prej 521.5 GWH me kosto prej €65.2 milion, duke llogaritur nga një subvencion prej €42 milion .
- Eksportet me vlerë prej €6.2 milion
- Pagesa e paralogaritur për KOSTT €15 milion
- Shitjet e paralogaritura për konsumatorët jo të privilegjuar 2,741.3 GWH
- Bazuar në diskutimet me ZRrE-në, bilanci energjetik fillestar ishte rregulluar për të paraqitur at që Feronikeli pritet të operoj me vetëm njërin nga dy furrat e tyre gjatë vitit 2009. Zvogëlimi i rreth 200 GWH ishte reflektuar në 100 GWH zvogëlim në import (në nivelin 521.5 GWH) dhe një rregullim 100 GWH në vlerën fillestare të humbjeve komerciale, që ishte jo reale.
- Humbjet Komerciale, të definuar nga ZRrE-ja si dallimi në mes (1) energjisë në dispozicion për Shpërndarje (pas rregullimit për humbjet teknike prej 17% në përdorim të brendshëm) dhe (2) energjisë së faturuar e cila është 23%. Kjo krahasohet me rezultatet aktuale të vitit 2008 prej 27%. KEK-u po përpiqet për të zvogëluar humbjet komerciale siç është demonstruar nga përmirësimi i parashikuar.
- Të Hyrat e Lejuara përfshijnë një shpenzim të lejuar si Borxh i Keq prej 2% e të hyrave, vlerë kjo shumë më e ulët se sa niveli aktual apo ai i projektuar.
- KEK-u pajtohet me ZRrE-në sa i përket çështjes së dizajnit tariforë si në vijim:
 - Tarifat individuale duhet të lëvizin më afër kostos për t'i shërbyer konsumatorët përkatës. Për faktin se konsumatorët shtëpiak përbëjnë përafërsisht 60% të ngarkesës; ato tarifa duhet të ngritën më shumë se përqindja mesatare e ngritjes, duke konsideruar se ato janë larguar nga kostoja për shërbimin e tyre në **revidimin** e fundit tariforë.
 - Nuk pritet ndonjë ndryshim i dukshëm në strukturat tarifore
 - Caktimi i çmimit për Kohën e përdorimit (periudhat e larta dhe të ulëta) do të vazhdoj dhe
 - Bllok struktura ekzistuese për konsumatorët shtëpiak do të vazhdojë

2 Strategjia Tarifore

Tarifat e propozuara përputhen me kërkesat e Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë të bazuara në Metodologjinë e Tarifave dhe në veçanti paraqesin kërkesat për kosto reflektuese dhe jo diskriminuese ashtu siç është e vendosur në atë metodologji.

Sipas kërkesës së Metodologjisë të Tarifave, KEK-u në vijim jep një shpjegim mbi përcaktimin e tarifave të rregulluara ekzistuese dhe lidhjen e detyrimeve përkatëse të kategorive të konsumatorëve me kostot që i shkakton ajo kategori e konsumatorëve

Synimet e KEK Sh. A. janë që konsumatorëve të zakonshëm tu ofrojë energji elektrike të kënaqshme sipas kërkesave të tyre me tarifa të bazuara në kosto. Prandaj strategjia e këtij Aplikimi Tarifor për vitin 2009 është që t'i sigurojë burimet e domosdoshme për të arritur këtë synim, posaçërisht në relacion me operimin e minierave, mirëmbajtjen, dhe shpenzimet kapitale.

KEK Sh. A. është i vetëdijshëm se gjatë një të ardhme të afërt, ka kufizime të kapacitetit të; (1) Gjenerimit, (2) Sistemit të Rrjetit të Transmisionit dhe (3) në disa pjesë të Rrjetit Shpërndarës. Gjithashtu, ka kufizime financiare për importin e energjisë elektrike që i nevojitet Kosovës. Këto kufizime do ta pengojnë KEK-un që t'u mundësojë konsumatorëve furnizim me energji elektrike pa ndërpre gjatë gjithë vitit, megjithatë KEK-u do të përpiqet që të operojë suksesshëm duke minimizuar numrin e reduktimeve ndaj konsumatorëve të zakonshëm.

Tarifat e propozuara janë të bazuara në nivel të tensionit (110, 35, 10(20), dhe 0.4)kV dhe në grupe tarifore. Duke u bazuar në analizat e kostove, grupet tarifore propozojmë të përmbajnë elemente të ndara tarifore siç janë:

- Ngarkesa fikse për konsumator,
- Ngarkesa e Fuqisë së Angazhuar për kategoritë e caktuara tarifore,
- Ngarkesa për Energjinë Aktive dhe
- Ngarkesa e Energjisë Reaktive për kategoritë e caktuara tarifore.

Tarifat po ashtu janë të bazuara në ndryshimin kostove sezonale (Verë dhe Dimër), dhe në atë ditore.

2.1 Tarifat e Furnizimit me Pakicë

Ky aplikim tarifor i përmbahet parimit të kostove reflektive, që do të thotë se çdo grup tarifor duhet të lëvizë drejt kostos përkatëse ashtu që konsumatorët e grupeve të ndryshme duhet të paguajnë vetëm kostot përkatëse të krijuara nga përdorimi i shërbimit me energji elektrike. Kjo nuk ka ndodhur në tarifat e tanishme pasi që të gjitha klasat e konsumatorëve kanë pasur përqindje të njëjtë të ngritjes. Është përkeqësuar edhe më tutje për faktin se konsumatorët shtëpiak të cilët veç shërbehen nën kosto, kanë pasur një ngritje më të ulët se të gjithë konsumatorët tjerë.

KEK-u propozon që të lëvizet drejt tarifave që reflektojnë koston, por KEK-u është në dijeni se një ndryshim i menjëhershëm në këto tarifa do të rezultonte në një rritje të madhe për disa grupe të konsumatorëve.

Tarifa e Furnizimit me Pakicë përbëhet nga katër komponentë:

- Tarifa Fikse(€/konsumator),
- Tarifa e Fuqisë Maksimale(€/kW); - aty ku aplikohet,
- Tarifa e Energjisë Aktive(€/kWh),
- Tarifa e Energjisë Reaktive(€/kVArh); – aty ku aplikohet.

KEK-u si ndërmarrje me orientim komercial është i kujdesshëm në mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të kufizuara. Por, duke e ditur që kjo është në përgjegjësin e Qeverisë së Republikë të Kosovës, KEK-u po punon me Ministrin për të rritur efektivitetin e Subvencioneve për rastet sociale. Korporata jonë do të ngritë efikasitetin duke zbatuar Rregulloren mbi Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji Elektrike dhe Rregullën për Shkyçje dhe Ri-kyçje të konsumatorëve që të minimizojë humbjet.

2.2 Tarifa e Shitjeve me Pakicë

Tarifat e shitjeve me pakicë për konsumatorët fundorë janë një kombinim i Tarifës së Mihjes/Gjenerimit/Importit, Tarifës të Transmisionit, Tarifës të Rrjetit Shpërndarës dhe Tarifës të Furnizimit. Secila nga këto përmban elementet të cilat pasqyrojnë kostot përkatëse.

- Tarifa Fikse për konsumator është llogaritur duke përdorur rezultatet e alokimit të koston për secilën kategori tarifore sipas relacionit vijues:

$$\text{Tarifa fikse (€/konsumator)} = \frac{\text{Kostot e konsumatorit të alokuar ndaj grupeve të konsumatorëve}}{\text{Numri total i faturave vjetore të konsumatorëve për grup}}$$

- Tarifa e Fuqisë Maksimale llogaritet për secilën kategori sipas relacionit vijues:

$$\text{Tarifa e fuqisë maksimale(€/kW)} = \frac{\text{Kostot të cilat lidhen me fuqinë maksimale të alokuara ndaj grupit të konsumatorëve}}{\text{Totali i fuqisë maksimale të faturuar të ngarkuar për grup}}$$

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Vlera e fuqisë maksimale të ngarkuar duhet të merret gjatë PIK-ut për nivel përkatës të tensionit. Matja dhe faturimi i fuqisë maksimale me matës të fuqisë(maksigraf), bëhet vetëm te konsumatorët e mëdhenj për shkak të kostos së lartë. Ndërsa, kostot e fuqisë për konsumatorët pa matës të fuqisë janë të përfshira në tarifën e energjisë(p. sh. kWh paraqet masën e ngarkesës).

- Tarifa e Energjisë Aktive është llogaritur për secilën kategori sipas relacionit vijues:

$$\text{Tarifa e Energjisë Aktive (€/kWh)} = \frac{\text{Kostot e energjisë të alokuar ndaj grupeve të konsumatorëve}}{\text{Totali i energjisë së matur për grup}}$$

- Tarifa e Energjisë Reaktive për konsumatorë të mëdhenj me matës adekuat është llogaritur sipas relacionit vijues:

$$\text{Tarifa e Energjisë Reaktive (€/kVArh)} = \frac{\text{Kostot e energjisë reaktivet të alokuara ndaj grupeve të konsumatorëve}}{\text{Totali i energjisë reaktive të konsumuar për grup}}$$

3 Të Ardhurat e Lejuara

Në këtë seksion janë të dhëna rezultatet e kostove të Lejuara të kërkuara të cilat mbulohen nga Divizionet e KEK-ut siç janë: Mihjet, Gjenerimi, Rrjeti dhe Furnizimi plus kostot për Drejtorinë Qendrore të KEK-ut, që është e alokuar në secilën prej divizioneve. Të Ardhurat e Lejuara për konsumatorët e rregulluar të llogaritura sipas Modelit Tariforë janë në vlerë prej 163,015,582 Euro.

Llogaritja e të Ardhurave të Lejuara të Divizioneve të KEK SH. A. është bërë duke u bazuar në Metodologjinë Tarifore të ZRrE-së dhe Modelit Tarifor të KEK-ut (Modeli i datës: 17 shkurt 2009). Shuma e llogaritur e të ardhurave duke u bazuar nga të dhënat energjetike dhe ato financiare finale do t'i mundësojnë Furnitorit Publik që të kthej kostot përmes tarifave që i ngarkohen konsumatorëve të rregulluar për furnizim me energji elektrike.

Në këtë shumë bëjnë pjesë:

- Të ardhurat e lejuara të furnizuesit publik, duke përfshirë energjinë elektrike nga Gjenerimi i KEK-ut dhe importi,
- Tarifa e Rrjetit të Transmisionit (KOSTT-it) për mundësimin e shërbimeve të transmisionit për konsumatorët jo të privilegjuar dhe
- Të ardhurat e përgjithshme të lejuara të Divizionit të Rrjetit për shërbimet e shpërndarjes për konsumatorët e rregulluar.
- Kostot e furnizimit për të gjithë konsumatorët

Të Hyrat Lejuara, të kërkuara janë të bazuara në vitin provues 2009. Viti provues 2009 është përdorur meqë tarifat e aprovuara finale nga ana e ZRrE-së në këtë aplikim do hyjnë në fuqi më 1 Prill të vitit 2009. Të gjitha të dhënat e Modelit Tariforë (Bilanci Energjetik, Kostot, etj.) janë të bazuara në vitin kalendarik 2009.

3.1 Të Ardhurat e Lejuara për Furnizim me Pakicë.


Tabela në vijim “Përmbledhja e Të Hyrave të Lejuara-2009” paraqet kostot e përgjithshme të tarifave të shitjeve me pakicës të cilat janë propozuar të inkasohen përmes tarifave të propozuara. Kjo tabelë është një përmbledhje e llogaritjeve të përfshira në Modelin Tariforë që është ofruar në këtë aplikim.

Përmbledhje e Të Hyrave të Lejuara-2009

Numri i Rendeve	Përshkrimi I artikullit	Minierat	Gjenerimi	Rrjeti Shpërndarës	Furnizimi	KEK Totali
1	SHPENZIMET VJETORE	48,726.0	34,494.2	20,094.0	19,904.5	123,218.7
2	KTHIMI	6,136.3	4,704.0	1,797.7	41.2	12,679.2
3	Margjina e Furnizimit (@3% për TC)				2,387.0	2,387.0
4	Importet				23,187.5	23,187.5
5	Blerjet në Tensionin e Rrjetit				3,015.0	3,015.0
6	Kredit i të Hyrave (Konsumatorët e Privilegjuar)				-9,420.0	-9,420.0
7	Shpenzimet e Borxhit të Keq				3,182.6	3,182.6
8	Të Hyrat Tjera nga Veprimtaria	-1,290.0				-1,290.0
9	Eksportet				-6,200.0	-6,200.0
10	Kostot e Alokua të DQ-së	5,825.0	2,754.5	2,931.5	744.5	12,255.5
11	Totali i të Hyrave të Lejuara	59,397.3	41,952.8	24,823.2	36,842.3	163,015.5

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Diagrami në vijim paraqet kostot e përmbledhura prej secilës fushë funksionale në shumën totale të të Hyrave të Lejuara.



Duke u bazuar në raportin e ZRrE-së të datës 19 Qershor 2008, mbi Bashkërendimin e të hyrave të Prillit dhe Majit, për shkak vonesës të aprovimit të Tarifave të KEK-ut për vitin e kaluar (1 Qershor 2008), ZRrE-ja i lejon KEK-ut kompensimin e të hyrave për ata dy muajt në vlerë prej €485,000 që t'i fusim në të Hyrat e Lejuara për vitin 2009. Kjo sasi nuk është përfshirë në Të Hyrat e Lejuara të caktuara nga KEK-u, mirëpo pritet të përfshihet nga ZRrE në tarifafat përfundimtare.

Shkycqjet e konsumatorëve që nuk paguajnë energjinë elektrike, kanë dhënë efekte pozitive. Ky aksion është përkrahur edhe nga ZRrE-ja, MEM-i dhe Policia. Ndërsa, nga Prokuroria është kërkuar më shumë bashkëpunim në trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me konteste mes KEK-ut dhe konsumatorëve.

Shkyçjet janë vegla më e rëndësishme për të zbatuar disiplinën e arkëtimit. KEK-u mirëpret rekomandimet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbi Zbatimin e Memorandumit për Çështje Sociale ne Kuadër te Traktatit për Komunitetin e Energjisë.

Derisa KEK-u të përmirësojë shkallën e arkëtimit deri në një nivel të arsyeshëm, do të dëshironte që të trajtohet në mënyrë më të orientuar për nga natyra komerciale dhe të zvogëlojmë barrën ndaj BKK-së duke përfshirë “Kostot për Borxhet e Këqija, në të hyrat e lejuara. Secila kompani komerciale e cila i krediton konsumatorët e vet, ballafaqohet me shpenzime për shkak të borxheve të këqija. Kjo ndodhë edhe me kompanitë me efikasitet të lart afarist. Për këtë arsye, KEK-u e ka përfshirë një lejim të shpenzimit të Borxhit të Keq prej 2% nga të hyrat, një vlerë shumë më e ulët se niveli historik dhe i projektuar.

Furnizuesi i KEK-ut i llogarit të hyrat e lejuara sipas Metodologjisë Tarifore. Ajo është shuma maksimale që i lejohet furnizuesit publik për t'i mbulua kostot nga ana e konsumatorëve jo të privilegjuar. Kjo përbëhet nga:

- Kostot e lejuara për blerjen e energjisë, që të dyja nga Gjenerimi i KEK-ut si dhe nga energjia elektrike e importuar.
- Një sasi e barabartë me 3% të kostove të lejuara të furnizimit për blerjen e energjisë; ashtu siç përshkruhet në Metodologjinë Tarifore dhe
- Kostot e lejuara me pakicë për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar (e barabartë me kostot e lejuara me pakicë për konsumator e shumëzuar me numrin e konsumatorëve të rregulluar).

4 Freskimi i tarifave ekzistuese

Tarifat e rregulluara ekzistuese janë të dhëna në Tabelën Raportuese 1. Ndërsa Tarifat e propozuara janë freskuar në përputhje me të ardhurat e lejuara të propozuara për vitin 2009 të cilat pasqyrohen në Tabelën Raportuese 2, duke mos ndryshuar strukturën e tarifave ekzistuese.

KEK-u ka zhvilluar modelin e vet tarifor dhe ka bërë një studim të Kostos së Shërbimit për të klasifikuar dhe për të alokuar të Hyrat e Lejuara për secilin grup të konsumatorëve. Kostot janë të klasifikuara si kosto fikse, kosto variabile dhe kosto të konsumatorëve. Të Hyrat e Lejuara më pas alokohen për secilin grup të konsumatorëve për të caktuar pjesën që i takon nga shuma e përgjithshme.

4.1 Studimi i Alokimit të Kostos (të Shërbimit)

Gjatë studimit të koston së shërbimit kemi përdorur faktorë të ndryshëm të alokimit për të alokuar secilën prej elementeve të koston për grupin tariforë të

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

konsumatorëve. Parimi i shkaktarit¹ të kostos është qasja tipike e përdorur për të zgjedhur alokimin adekuat për secilin prej elementeve të kostos.

Faktorët e përdorur për të alokuar Të Hyrat e lejuara nëpër klasat tarifore

Faktori i Alokimit	Emri	Përshkrimi	Kostoja e Alokuar
1	Energjia (kWh) Bruto Në Nivelin e Tensionit të Lartë	Herësi, në përqindje, i shitjes së energjisë vjetore totale për secilin grup tarifor kundër totalit të shitjeve vjetore të energjisë në sistem	Kostot e ndryshueshme të gjenerimit dhe kostot tjera të ndryshueshme të furnizimit
2	Energjia (kWh) Bruto Në Nivelin e Tensionit të Mesëm	Herësi, në përqindje, i shitjes së energjisë vjetore totale për secilin grup tarifor kundër totalit të shitjeve vjetore të energjisë në sistem	Kostot e ndryshueshme të gjenerimit dhe kostot tjera të ndryshueshme të furnizimit
3	Pjesa e Ndarë e Rastësishme në Tensionin e Lartë	Herësi, në përqindje, i fuqisë së angazhuar për secilin grup tariforë në kohën e pikut të sistemit ndaj fuqisë maksimale të pikut të sistemit	Kostoja fikse e përfshirë në gjenerimin e energjisë elektrike
4	Pjesa e Ndarë e Rastësishme në Tensionin e Mesëm	Herësi, në përqindje, i fuqisë së angazhuar për secilin grup në kohën pikut të tensionit të mesëm ndaj maksimumit të fuqisë së angazhuar në pikun e tensionit të mesëm	Kostoja fikse e përfshirë në gjenerimin e energjisë elektrike
5	Konsumatorët	Herësi, në përqindje, i mesatares së numrit të përgjithshëm të konsumatorëve për secilin grup tarifor me shumën e mesatares së numrit të konsumatorëve për të gjitha grupet tarifore të konsumatorëve.	Pjesë e kostos që ka të bëjë me konsumatorët

¹ Shkaktari i kostos zakonisht është principi qendror i alokimit të të gjitha kostove. Ky princip nënkupton se një kosto është alokuar në bazë të faktorit që e shkaktonte koston. Për shembull, një kompani shpërndarëse duhet të investojë në ndërtimin e kapacitetit të shpërndarjes për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve gjatë pikut. Investimet në kapacitet korrespondojnë me kërkesën e pikut dhe kështu shkaktonte shpenzimet e investimit. Nëse e ndjek këtë, shpenzimi i investimit do të lejohet bazuar në disa matje të përgjithshme të pikut të grupeve të ndryshme të konsumatorëve ose kategorive të shërbimit. (Instituti i Kërkimeve të Rregullatorit Kombëtarë)

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative


6	Konsumatorët e Maturë	Raporti, në përqindje, i numrit të përgjithshëm të konsumatorëve të mature të secilit grup tariforë me shumën e numrit të matur të konsumatorëve për të gjithë grupet tarifore të konsumatorëve. Kjo jep koston relative në mes grupeve tarifore për disa prej kostove që kanë të bëjnë me konsumatorin	Një pjesë e koston që ka të bëjë me konsumatorin siç janë njehsimi dhe faturimi.
---	-----------------------	---	--

4.2 Procesi Tarifor

Në zhvillimin e tarifave të propozuara, ky diagram paraqet procesin të cilin KEK-u rekomandon që të përdoret në të ardhmen. Procesi është konform Ligjit dhe Udhëzimeve të Metodologjisë Tarifore të ZRRë-së.

Rezultati nga ky proces do jetë që të ndajë (të shthurë) tarifatat që të pasqyrojnë koston e gjenerimit të energjisë elektrike dhe të importit dhe koston e rrjetit (transmisionin dhe shpërndarjen).

PROCESI I KRIJIMIT TARIFOR TE KEK-ut



Shënim: Kostot e divizioneve të Mijes, Gjenerimit, Rrjetit dhe Furnizimit përfshin një alokim të drejtorisë qendrore (mbështetja korporative) kostot.

4.3 Përcaktuesit e Faturimit

Përcaktuesit e faturimit janë elemente tarifore që maten në bazë të cilëve aplikohen çmimet për të llogaritur faturat e konsumatorëve.

Përcaktuesit e faturimit përfshijnë:

- Ngarkesën fikse të konsumatorëve,
- Ngarkesën fikse të fuqisë (kW); aty ku aplikohet,
- Ngarkesën për Energjinë Aktive (kWh), dhe
- Ngarkesën për Energjinë Reaktive (kVARh), aty ku aplikohet.

Modeli Tariforë llogaritë përcaktuesit e faturimit për secilën klasë të konsumatorëve bazuar në të dhënat e faturimit për vitin 2008 të aplikuar në bilancin energjetik të vitit 2009. Të dhënat e vitit 2008 përdoren për të llogaritur përqindjen e energjisë së faturuar në secilin bllok për t'i përdorur më pastaj energjinë e përgjithshme të faturuar për secilën klasë të konsumatorëve në vitin 2009.

KEK-u ka mbledhur përcaktuesit e tanishëm të faturimit për vitin 2008 për secilin grup të konsumatorëve dhe i ka përdorur përcaktuesit e faturimit për vitin 2009

Përmbledhja e Përcaktuesve të faturimit të KEK-ut për 2008

Grupi Tariforë	Përcaktuesit e Faturimit		2009 Përcaktuesit e Faturimit
	Përshkrimi i Njesisë së Matur	Njësi e Faturuar çdo Muaj	
0 TL Industrial	Faturat e Konsumatorëve	€	24
	KW	€/kW	157,477
	Verë kWh		
	Në Pik	€/kWh	26,111,949
	Jashtë Pikut	€/kWh	21,306,957
	Dimër kWh		
	Në Pik	€/kWh	21,133,783
	Jashtë Pikut	€/kWh	20,547,311
	Varhr	€/kVARh	
1 (35 kV)	Faturat e Konsumatorëve	€	250
	KW	€/kW	95,000
	Verë kWh		
	Në Pik	€/kWh	10,308,741
	Jashtë Pikut	€/kWh	6,863,907
	Dimër kWh		
	Në Pik	€/kWh	14,819,125
	Jashtë Pikut	€/kWh	10,008,227
	Varhr		33,000,000
2	Faturat e Konsumatorëve	€	2,820

Grupi Tariforë	Përcaktuesit e Faturimit		2009 Përcaktuesit e Faturimit
	Përcaktuesit e Faturimit	Njësi e Faturuar çdo Muaj	
5 Shtëpiak Njehsorë 2 tariforë	Faturat e Konsumatorit	€	3,300,000
	< 200 kWh		
	Verë kWh		
	Në Pik	€/kWh	134,412,804
	Jashtë Pikut	€/kWh	137,537,114
	Dimër kWh		
	Në Pik	€/kWh	135,276,492
	Jashtë Pikut	€/kWh	136,721,437
	200-600 kWh		
	Verë kWh		
	Në Pik	€/kWh	138,251,783
	Jashtë Pikut	€/kWh	162,167,604
	Dimër kWh		
	Në Pik	€/kWh	158,329,968
Jashtë Pikut	€/kWh	186,251,337	
> 600 kWh			
Verë kWh			
Në Pik	€/kWh	83,647,529	
Jashtë Pikut	€/kWh	90,447,017	

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

(10 kV)	KW	€/kW	576,751
	Verë kWh		
	Në Pik	€/kWh	50,016,353
	Jashtë Pikut	€/kWh	35,253,572
	Dimër kWh		
	Në Pik	€/kWh	59,576,229
	Jashtë Pikut	€/kWh	41,153,845
	Varhr		58,797,925
3 Kategoria I (0.4 kV)	Shumë Tariforë		
	Faturat e Konsumatorëve	€	11,700
	KW	€/kW	679,409
	Verë kWh		
	Në Pik	€/kWh	45,725,509
	Jashtë Pikut	€/kWh	30,086,646
	Dimër kWh		
	Në Pik	€/kWh	49,697,651
	Jashtë Pikut	€/kWh	33,280,936
Varhr	€/kVARh	37,291,576	
4 Kategoria II 1 Tarifor	Një Tarifotë		
	Faturat e Konsumatorit	€	258,000
	Verë kWh	€/kWh	29,003,285
	Dimër kWh	€/kWh	37,484,950
4 Kategoria II (0.4 kV) 2 Tarifor	Faturat e Konsumatorit		432,000
	KW	€/kW	
	Verë kWh		
	Në Pik	€/kWh	67,781,527
	Jashtë Pikut	€/kWh	54,347,582
	Dimër kWh		
Në Pik	€/kWh	81,984,196	
Jashtë Pikut	€/kWh	58,679,795	

	Dimër kWh		
	Në Pik	€/kWh	135,341,347
	Jashtë Pikut	€/kWh	168,390,696
6 Shtëpiak Njehsorë 1 Tariforë	Faturat e Konsumatorit	€	640,000
	< 200 kWh		
	Verë kWh	€/kWh	39,842,902
	Dimër kWh	€/kWh	39,752,180
	200-600 kWh		
	Verë kWh	€/kWh	28,167,015
	Dimër kWh	€/kWh	30,486,874
	> 600 kWh		
Verë kWh	€/kWh	12,120,215	
Dimër kWh	€/kWh	15,302,191	
7 Të pamatur Shtëpiak	Faturat e Konsumatorit	€	50,000
	< 400 kWh		
	Verë kWh	€/kWh	12,917,271
	Dimër kWh	€/kWh	13,146,239
	Faturat e Konsumatorit		70,000
	400-800 kWh		
	Verë kWh	€/kWh	30,932,642
	Dimër kWh	€/kWh	30,939,619
Faturat e Konsumatorit		4,500	
> 800 kWh			
Verë kWh	€/kWh	3,357,851	
Dimër kWh	€/kWh	3,459,873	
8 Ndrçimi Publik	Faturat e Konsumatorit	€	6,120
	Verë kWh	€/kWh	4,647,102
	Dimër kWh	€/kWh	4,280,820

4.4 Tarifat e Propozuara

Tarifat e reja mund të përcaktohen në disa mënyra të ndryshme. Modeli Tariforë i llogaritë tarifrat duke u bazuar në alokimin e kostos së tij.

Tradicionalisht, rritja e përgjithshme në tarifa përcaktohet, fillimisht duke përcaktuar rritjen në kërkesat e përgjithshme të të hyrave. Tabela në vijim jep këtë informatë. Të hyrat në tabelë janë llogaritur nga përcaktuesit e faturimit të përfshirë në Modelin Tariforë;

Të Hyrat e Lejuara janë llogaritur në Modelin Tariforë.

Tabela 2b

A. Konsumatorët e rregulluar

Grupi Tarifor	Te Hyrat e Llogaritura për 2009		
	Tarifat Ekzistuese	Tarifat e Propozuara	% Ndryshimi
0	€ 3,554,795	€ 3,839,179	8.00%
1	€ 2,557,508	€ 2,762,109	8.00%
2	€ 11,992,692	€ 12,952,108	8.00%
3	€ 11,417,104	€ 12,330,472	8.00%
4	€ 28,875,995	€ 31,186,074	8.00%
5	€ 76,449,252	€ 84,851,025	10.99%
6	€ 8,813,537	€ 9,833,263	11.57%
7	€ 3,998,000	€ 4,453,372	11.39%
8	€ 750,322	€ 810,348	8.00%
Total	€ 148,409,205	€ 163,017,950	9.84%

B. Konsumatorët e privilegjuar

Konsumatorët e privilegjuar	€ 9,411,000	€ 9,411,000	0.00%
-----------------------------	-------------	-------------	-------

C. Totali i te Hyrave te Lejuara

Te Hyrat Totale	€ 157,820,205	€ 172,428,950	9.26%
-----------------	---------------	---------------	-------

Të hyrat për 2009 janë të përcaktuara duke përdorur tarifrat ekzistuese dhe të propozuara për të paraqitur ndryshimin.

Tarifat e Modelit Tarifor për vitin 2009 janë të paraqitura në Tabelën 2a. Tabela gjithashtu tregon % e ngritjes që do të rezultojë për çdo bllok në secilën kategori tarifore.¹

Tabela 2b paraqet tarifat e rekomanduara nga KEK-u për secilën kategori tarifore. KEK-u bënë këto propozime që ndryshojnë nga rezultatet e modelit, duke arsyetuar si në vijim:

1. KEK beson se asnjëra nga tarifat përbrenda kategorive nuk duhet të zvogëlohet ashtu siç e paraqet rezultati i modelit. (shiko #3 për justifikim për këtë deklaratë)
2. KEK propozon që tarifat për konsumatorët shtëpiak të mos rriten menjëherë deri në nivelet e kostos së shërbimeve sepse një lëvizje e tillë do të shkaktonte një shokë të normës për ata konsumatorë, megjithatë duhet të lëvizin më afër kostos së shërbimit.
3. Futjet e të dhënave për modelin e ZRrE-së përmbajnë shumë supozime që duhet të ekzaminohen nga ZRrE-ja dhe se KEK-u para aplikimit të ardhshëm tariforë beson se modeli i tanishëm përmban shumë supozime të gabueshme që nuk janë më të vlefshëm; këto supozime nxjerrin rezultate që nuk janë të sakta. Për shembull, modeli nxjerr çmime për konsumatorët e Kategorisë 0 (110 kV) gjatë periudhës së ultë të verës që janë më të ulëta sesa kosto me të cilën KEK-u mund të prodhojë energji.

4.5 Të Ndryshme

Më 1 Dhjetorë 2008, Kreu i ZRrE-së ka lëshuar një letër² lidhur me aplikimin tarifor. Në këtë letër Dr. Ali Hamiti shkruan: “Duhet të ketë një lëvizje graduale në tarifat që reflektojnë kostot. Tarifat e shqyrtuara duhet të vazhdojnë të lëvizin në drejtim të tarifave që reflektojnë kostot (kosto reflektive), duke përfshirë edhe ribalancimin e tarifave relative industriale, komerciale dhe shtëpiake, gjersa në të njëjtën kohë janë marr parasysh edhe çështjet e përbalueshmërisë së pagesës”. KEK-u këtu lëvizë drejt tarifave të cilat më shumë reflektojnë kostot.

² Shiko letrën e Ali Hamitit me temë “ Shqyrtimi i Aplikimit të Tret Tarifor (ETR3) - Parimet dhe Afatet

5 Ndryshimet e propozuara

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A.) ka propozuar ndryshime në strukturën tarifore të energjisë elektrike për Grupin Tarifor 7; 0.4kV(shtëpiak pa matës). Tarifat sezonale nuk janë adresuar këtu pasi që KEK-u beson që tarifat e shitjeve me pakicë janë të caktuara me vend për secilën sezon. që ndryshimet e kostos në mes periudhave të verës dhe dimrit janë të tilla.

Pritet që strukturat e propozuara tarifore, së bashku me çmimet e freskuara, do të hyjnë në fuqi me 01 Prill të vitit 2009.

5.1 Përshkrimi i Modifikimit të Grupeve Tarifore

Grupi Tarifor 0 (110 kV)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

Grupi Tariforë 1 (35 kV)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

Grupi Tariforë 2 (10 kV)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

Grupi Tariforë 3 (Kategoria I – 0.4 kV)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

Grupi Tariforë 4 (Kategoria II – 0.4 kV)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

Grupi Tarifor 5 (Amvisëri me matës II- tarifor)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

Grupi Tarifor 6 (Amvisëri me matës I- tarifor)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

Grupi Tariforë 7 (të Pamatur)

Propozim në strukturën tarifore: Të kufizohet koha e shfrytëzimit të këtij grupi për konsumatorë; p.sh. 90 ditë.

(Për të zvogëluar gradualisht numrin e konsumatorëve në këtë grup duhet të propozojmë kosto të larta duke u bazuar në analizën e normave të arkëtimit të këtij grupi. KEK-u pajtohet me ZRrE-në që konsumatorët ekzistues duhet të kalojnë nga kjo kategori tarifore në kategori të matur. KEK-u do dëshironte që ta ruaj këtë tarifë; megjithatë duhet të ketë një mekanizëm për të faturuar konsumatorët derisa të instalohet një njehsorë i KEK-ut.

Grupi Tariforë 8 (Ndriçimi Publik)

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore.

6 Këshillimet

Grumbullimi i të dhënave, përpunimi dhe finalizimi i këtij Aplikacioni Tarifor është kryer pas analizave të thella të kërkesave të bilancit energjetik, të strukturës së kostove, strukturës së mjeteve themelore dhe pasqyrave financiare.

Në vijim është i dhënë itinerari i aktiviteteve të zhvilluara gjatë këshillimeve dy paleshe KEK dhe ZRrE. Ju lutemi referohuni tabelës e cila përmbledhë këto aktivitete.

Data	Përshkrimi i Aktivitetit
4 Shtator 2008	Takim ZRRE – KEK; Diskutim parapërgatitor për Aplikimin Tarifor (SHTE3); Temat: Modeli Tarifor, Zhvlerësimi, Shturja e Tarifave, Periudha testuese, dhe Afati për Aplikim.
2 Dhjetor 2008	ZRRE i dërgon KEK-ut njoftim për Aplikimin Tarifor: - Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE3); Parimet dhe Orari, - Udhëzuesin mbi Modelin e të Hyrave dhe Tarifave (RTM)
3 Dhjetor 2008	KEK-u kërkon takim me ZRRE-në për SHTE3 – Parimet dhe Orarin. ZRRE cakton takimin më 04.12.2008
4 Dhjetor 2008	Takim në zyrat e ZRRE-së lidhur me SHTE3 – Parimet dhe Orari.
5 Dhjetor 2008	KEK-u dërgon Komentet lidhur me SHTE3 në ZRRE.
10 Dhjetor 2008	ZRRE dërgon KEK-ut Shabllonet për Aplikim Tarifor
19 Dhjetor 2008	ZRrE dërgon KEK-ut përgjigjet ndaj komenteve të KEK-ut lidhur me SHTE3 dhe RTM të ZRrE-së
22 Dhjetor 2008	KEK-u dërgon ZRrE-së kërkesë për shtyrjen e afatit të dorëzimit të Aplikacionit Preliminar Tarifor 2009
31 Dhjetor 2008	KEK-u dërgon ZRrE-së Aplikimin Preliminar të SHTR3 me Template të plotësuara dhe Bazën e Mjeteve Themelore të KEK-ut për vitin 2009
5 Janar 2009	ZRrE kërkon nga KEK-u sqarime rreth të dhënave financiare dhe energjetike të plotësuara në Template të Aplikimit Preliminar të datës 31.12.2008
8 Janar 2009	KEK-u i dërgon përgjigjet ZRrE-së lidhur me pyetjet e datës 5 Janar 2009.
13 Janar 2009	KEK-u i dërgon ZRrE-së sqarime shpesh lidhur me Subvencionet për Import të Energjisë Elektrike për vitin 2009.
19 Janar 2009	KEK-u kërkon nga ZRrE-ja takim konsultativ lidhur me disa çështje të SHTR3-it.
20 Janar 2009	ZRrE i dërgon KEK-ut Komentet lidhur me Aplikacionin Preliminar për të hyrat e lejuara dhe tarifa të KEK sh. a.
22 Janar 2009	ZRrE refuzon kërkesën e KEK-ut për takim konsultativ lidhur me çështjet e SHTR3 të
26 Janar 2009	KEK-u i dërgon ZRrE-së përgjigjet lidhur me Aplikimin Preliminar për të hyra të lejuara dhe tarifa të KEK sh. a. të datës 20.01.2009
11 Shkurt 2009	KEK-u kërkon nga ZRrE-ja takim konsultativ lidhur me çështjet tarifore të SHTR3.
11 Shkurt 2009	ZRrE-ja miraton kërkesën e KEK-ut për takim dhe cakton datën 12.02.2009.
12 Shkurt 2009	Takim në ZRrE për tarifa në mes të përfaqësuesve të KEK-ut dhe atyre të ZRrE-së
18 Shkurt 2009	KEK-u dërgon Aplikimin Tarifor 2009 në ZRrE.

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

7 Tabela nr. 1, Tarifat ekzistuese

Grupi Tariforë	Niveli I tensionit te furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Sez. e Lartë	Sez. e ulët
					€/njësi	€/njësi
0	110 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		981	
		Fuqia e angazhuar	Ec/kW		545	545
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	Ec/kWh	Tarifa e lartë	6.33	1.87
			Ec/kWh	Tarifa e ulët	2.63	1.54
Energjia reaktive (Q), b)	Ec/kVah		0	0		
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		130	
		Fuqia e angazhuar	Ec/kW		567	567
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	Ec/kWh	Tarifa e lartë	6.62	2.87
			Ec/kWh	Tarifa e ulët	3.5	2.59
Energjia reaktive (Q), b)	Ec/kVah		0.64	0.64		
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		54	
		Fuqia e angazhuar	Ec/kW		489	489
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	Ec/kWh	Tarifa e lartë	7.42	3.31
			Ec/kWh	Tarifa e ulët	4	3.01
Energjia reaktive (Q), b)	Ec/kVah		0.64	0.64		
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzim të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		30	
		Fuqia e angazhuar	Ec/kW		284	284
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	Ec/kWh	Tarifa e lartë	8.24	4.58
			Ec/kWh	Tarifa e ulët	5.2	4.32
Energjia reaktive (Q), b)	Ec/kVah		0.64	0.64		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		34	
		Energjia aktive (P)	Ec/kW	Tarifa e vetme	10.16	6.57
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	Ec/kWh	Tarifa e lartë	12.22	8.01
			Ec/kWh	Tarifa e ulët	6.11	4
5	Tariforë (2-vlerësh)	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		24	
		Energjia aktive (P), prej së cilës:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	Ec/kWh	Tarifa e lartë	4.53	3.25
			Ec/kWh	Tarifa e ulët	2.27	1.62
		200-600kWh/muaj(Blloku i dytë) prej të cilit	Ec/kWh	Tarifa e lartë	6.27	4.49
			Ec/kWh	Tarifa e ulët	3.14	2.25
>600kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit	Ec/kWh	Tarifa e lartë	9.1	6.52		
	Ec/kWh	Tarifa e ulët	4.55	3.27		
6	shtëpiak b)	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		24	
		Energjia aktive (P), prej së cilës:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë)	Ec/kWh	Tarifa e vetme	4.04	2.89
		200-600kWh/muaj(Blloku i dytë)	Ec/kWh	Tarifa e vetme	5.59	4
>600kWh/muaj (Blloku i tretë)	Ec/kWh	Tarifa e vetme	8.11	5.81		
7	0.4kV (shtëpiak pa mates	<200kWh/muaj (Blloku i parë)	E/konsumator/muaj		21	
		200-600kWh/muaj(Blloku i dytë)	E/konsumator/muaj		38	
		>600kWh/muaj (Blloku i tretë)	E/konsumator/muaj		64.00	
8	Ndriqimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	E/kons./vit		34.00	
		>600 kWh/muaj (Blloku I trete)	Ec/kWh	Tarifa e vetme	8.21	8.21

a) Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00 - 22:00 gjatë sezonës së lartë dhe prej 08:00-23:00 gjatë sezonit të ulët

b) Konsumatori ngarkohet me energji reaktive të shpenzuar mbi atë të lejuar $\cos \Phi = 0.95$

8 Tabela nr. 2, Tarifat e Propozuara krahasuar me tarifat ekzistuese

Grupi Tarifor	Përcaktuesit e Faturimit		Tarifat		
	Përshkrimi i Njesis se Matur	Njësia e Faturuar çdo Muaj	2008	2009	% Ndryshimi
0 110 kV Industrial	Faturat e Konsumatorëve	€	€81.75	€88.29	8.00%
	KW	€/kW	€5.45	€5.89	8.00%
	Vere kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0187	€0.0202	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0154	€0.0166	8.00%
	Dimër kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0633	€0.0684	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0263	€0.0284	8.00%
	Varhr	€/kVARh			
1 (35 kV)	Faturat e Konsumatorëve	€	€10.83	€11.70	8.00%
	KW	€/kW	€5.67	€6.12	8.00%
	Vere kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.03	€0.0310	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.03	€0.0280	8.00%
	Dimër kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.07	€0.0715	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.04	€0.0378	8.00%
	Varhr		€0.01	€0.0069	8.00%
2 (10 kV)	Faturat e Konsumatorëve	€	€4.50	€4.86	8.00%
	KW	€/kW	€4.89	€5.28	8.00%
	Vere kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0331	€0.0357	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0301	€0.0325	8.00%
	Dimër kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0742	€0.0801	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0400	€0.0432	8.00%
	Varhr		€0.0064	€0.0069	8.00%
3 Kategoria I (0.4 kV)	Faturat e Konsumatorëve	€	€2.50	€2.70	8.00%
	KW	€/kW	€2.84	€3.07	8.00%
	Vere kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0458	€0.0495	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0432	€0.0467	8.00%
	Dimër kWh				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0824	€0.0890	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0520	€0.0562	8.00%
	Varhr		€0.0064	€0.0069	8.00%
4	Faturat e Konsumatorëve	€	€2.83	€3.06	8.00%

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Kategoria II (0.4 kV)	<i>Një Tarifor</i>				
	Verëj kWh	€/kWh	€0.0657	€0.0710	8.00%
	Dimër kWh	€/kWh	€0.1016	€0.1097	8.00%
	<i>Shumë-tarifor</i>				
	Faturat e Konsumatorëve		€2.83	€3.06	8.00%
	<i>Vere kWh</i>				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0801	€0.0865	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0400	€0.0432	8.00%
	<i>Dimër kWh</i>				
	Ne Pik	€/kWh	€0.1222	€0.1320	8.00%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0611	€0.0660	8.00%

Grupi	Përcaktuesit e Faturimit		Tarifat		
	Përshkrimi i Njësia se Matur	Njësia e Faturuar çdo Muaj	Tarifor	Përshkrimi i Njësia se Matur	Njësia e Faturuar çdo Muaj
5 Shtëpiak me njehsor 2 tarifor	Faturat e Konsumatorëve	€	€2.00	€2.22	10.99%
	< 200 kWh				
	<i>Vere kWh</i>				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0325	€0.04	10.99%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0162	€0.02	10.99%
	<i>Dimër kWh</i>				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0453	€0.05	10.99%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0227	€0.03	10.99%
	200-600 kWh				
	<i>Vere kWh</i>				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0449	€0.05	10.99%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0225	€0.02	10.99%
	<i>Dimër kWh</i>				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0627	€0.07	10.99%
	Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0314	€0.03	10.99%
	> 600 kWh				
	<i>Vere kWh</i>				
	Ne Pik	€/kWh	€0.0652	€0.07	10.99%
Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0327	€0.04	10.99%	
<i>Dimër kWh</i>					
Ne Pik	€/kWh	€0.0910	€0.10	10.99%	
Jashtë Pikut	€/kWh	€0.0455	€0.05	10.99%	
6 Shtëpiak njehsor 1 tarifor	Faturat e Konsumatorëve	€	€2.00	€2.23	11.57%
	< 200 kWh				
	Verë kWh	€/kWh	€0.0289	€0.0322	11.57%
	Dimër kWh	€/kWh	€0.0404	€0.0451	11.57%
	200-600 kWh				

Zyra për Tarifa dhe Çështje Rregullative

	Verë kWh	€/kWh	€ 0.0400	€ 0.0446	11.57%
	Dimër kWh	€/kWh	€ 0.0559	€ 0.0624	11.57%
	> 600 kWh				
	Verë kWh	€/kWh	€ 0.0581	€ 0.0648	11.57%
	Dimër kWh	€/kWh	€ 0.0811	€ 0.0905	11.57%
7	Faturat e Konsumatorëve	€	€ 21.00	€ 23.39	11.39%
	< 400 kWh				
	Faturat e Konsumatorëve	€	€ 38.00	€ 42.33	11.39%
	400-800 kWh				
	Faturat e Konsumatorëve	€	€ 64.00	€ 71.29	11.39%
	> 800 kWh				
8	Faturat e Konsumatorëve	€	€ 2.83	€ 3.06	8.00%
	Verë kWh	€/kWh	€ 0.08	€ 0.0887	8.00%
	Dimër kWh	€/kWh	€ 0.08	€ 0.0887	8.00%